



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 15921 Prot

Lezhë, më 26/09/2022

VENDIM

Nr. 107, Datë 23.09.2022

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË EMËRTIMIT TË RRUGËS NR.03130037, NË  
FSHATIN PATALEJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE KOLSH, NGA RRUGA "PAPA  
GJON PALI II", NË RRUGA "CARMEN HERNANDEZ"

Në mbështetje të nenit 54, gërma "II", nenit 55 pika 2, nenit 64 gërma "ë", të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 3,5,8,30 të ligjit nr.9270 datë 29.07.2004 "Për Sistemin e Adresave" i ndryshuar, shkresës nr.174/1 prot., datë 17.08.2022 të Njesisë Administrative Kolsh, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1. Miratimin e ndryshimit të emërtimit të rrugës nr.03130037, të ndodhur në Fshatin Patalej, Njësia Administrative Kolsh, nga rruga "Papa Gjon Pali II", në rruga "Carmen Hernandez".
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, Njësia Administrative Kolsh.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Prot 15923/  
Dt 28.9.22

Nr. 6777 Prot.

Lezhë, më 28.9.2022

**Lënda: Konfirmim vendimi**

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16 pika 2, germa "b", të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", nenin 9, pika 1.1, germa "b" dhe pika 1.7, germa "b", nenin 54, germa "ll", si dhe nenin 55 pika 2, të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në ligjin nr.9270, datë 29.07.2004 "Për Sistemin e Adresave" i ndryshuar, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.107, datë 23.09.2022, të këshillit të bashkisë Lezhë, për "Miratimin e ndryshimit të emërimit të rrugës nr.03130037, në fshatin "Patalej" njësia administrative Kolsh, nga rruga "Papa Gjon Pali II", në rruga "Carmen Hernandes" .

**PREFEKTI**  
**Gjergj PRENDI**